

Në bazë të nenit 13 paragrafi (1) të Ligjit për Qendrën Shtetërore të Provimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 142/08, 148/09, 41/14, 55/16, 142/16 dhe 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 59/25) dhe nenit 5 paragrafi 1 të Rregullores për mënyrën, procedurën dhe kriteret e përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve të Qendrës Shtetërore të Provimeve, nr. 01-440/3 datë 28.12.2022, nr. 01-176/3, datë 1.3.2023, nr. 01-197/3 datë 15.4.2024 nr. 01-109/3 datë 11.02.2025, dhe nr. 01-157/4 datë 25.3.2025, në lidhje me nenin 2 paragrafi 15 të Ligjit për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesionalë në shkolla fillore dhe të mesme ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 161/19) dhe Rregullore e programit për dhënien e provimit profesional për mësimdhënës – praktikant dhe bashkëpunëtor profesional – praktikant dhe për mënyrën e realizimit të provimit profesional ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 121/20), Qendra Shtetërore e Provimeve Shkup shpall

KONKURS PUBLIK TË PËRSËRITUR

për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm - kryetarë dhe zëvendës-kryetarë të komisioneve profesionale për realizimin e provimit të praktikantit për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesional nga shkollat fillore dhe të mesme

1. Qendra Shtetërore e Provimeve shpall Konkurs publik për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm - kryetarë dhe zëvendës-kryetarë të komisioneve profesionale për realizimin e provimit të praktikantit për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesionalë nga shkollat fillore dhe të mesme, sa vijon:

1. Gjuhë Maqedonase dhe Gjuhë Maqedonase dhe Letërsi – 1 (një) bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore maqedonase (zëvendës-kryetar);
2. Gjuhë Turke dhe Gjuhë Turke dhe Letërsi – 2 (dy) bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore turke;
3. Gjuhë dhe kulturë Serbe, Rome, Boshnjake, Vllahe – 2 (dy) bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore serbe/rome/boshnjake ose vllahe;
4. Mësimdhënës për grupin klasor në gjuhën turke – 2 (dy) bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore turke;
5. Fizikë – 2 (dy) bashkëpunëtorë të jashtëm (një në gjuhën mësimore maqedonase dhe një në gjuhën mësimore shqipe);
6. Kimi dhe shkencat e natyrës – 1 (një) bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore shqipe;
7. Gjeografi – 1 (një) bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore shqipe;
8. Histori – 1 (një) bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore shqipe;
9. Gjuhë gjermane – 1 (një) bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore maqedonase;
10. Gjuhë italiane – 2 (dy) bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore maqedonase;
11. Arsim teknik – 2 (dy) bashkëpunëtorë të jashtëm (një në gjuhën mësimore maqedonase dhe një në gjuhën mësimore shqipe);
12. Art figurativ, Arsim figurativ, Arsim artistik – art figurativ dhe dizajn dhe profesioni grafik – 2 (dy) bashkëpunëtorë të jashtëm (një në gjuhën mësimore maqedonase dhe një në gjuhën mësimore shqipe);
13. Art muzikor, Arsim muzikor, Arsim artistik – Art muzikor dhe balet ART MUZIKOR, ARSIM MUZIKOR, ARSIM ARTISTIK – ART MUZIKOR DHE BALET – 1 (një) bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore shqipe;
14. Pedagogji dhe Pedagogë – 1 (një) bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore shqipe;

15. Edukatorë specialë (Defektologë, Logopedë) – 1 (një) bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore shqipe;
16. Sektori/Profesioni: Shëndetësor/Shëndetësi dhe Mbrojtje sociale dhe avancimi I shëndetit publik – 1 (një) bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore shqipe;
17. Profesioni/Sektori: Hotelierik-turistik / Hotelieri dhe turizëm – 1 (një) bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore shqipe;
18. Profesioni/Sektori: Bujqësi-Veterinari / Bujqësi, Peshkatori Dhe Veterinari – 2 (dy) bashkëpunëtorë të jashtëm (një në gjuhën mësimore maqedonase dhe një në gjuhën mësimore shqipe);
19. Profesioni/Sektori: Kimi-Teknologji/Kimi dhe Teknologji – 1 (një) bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore shqipe;
20. Profesioni/Sektori: Tekstil-Lëkurë/Tekstil, lëkurë dhe produkte të ngjashme – 2 (dy) bashkëpunëtorë të jashtëm (një në gjuhën mësimore maqedonase dhe një në gjuhën mësimore shqipe);
21. Profesioni/Sektori: Trafik/Trafiku, transporti dhe magazinimi – 1 (një) bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore shqipe;
22. Profesioni/Sektori: Makineri/Makineria – 1 (një) bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore shqipe;
23. Profesioni/Sektori: Elektroteknik/Elektroteknikë – 1 (një) bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore shqipe;
24. Profesioni/Sektori: Ekonomik-Juridik dhe Tregtar/Ekonomi, Drejtësi e Tregti dhe inovacione – 1 (një) bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore shqipe;
25. Profesioni/Sektori: Ndërtimtari-Gjeodezi/Ndërtimtaria dhe gjeodezia – 1 (një) bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore shqipe;
26. Profesioni/Sektori: Shërbime Personale – 2 (dy) bashkëpunëtorë të jashtëm (një në gjuhën mësimore maqedonase dhe një në gjuhën mësimore shqipe);
27. Profesioni/Sektori: Pylltari-Përpunimi i drurit/Pylltari dhe përpunimi i drurit – 2 (dy) bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore maqedonase;
28. Profesioni/Sektori: Gjeologji-Xehetari dhe metalurgji/Gjeologji, xehetari dhe metalurgji – 2 (dy) bashkëpunëtorë të jashtëm në gjuhën mësimore maqedonase;

II. Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të ketë të kryer të paktën studime akademike të ciklit të parë nga lënda përkatëse, përkatësisht nga profesioni/sektori përkatës;
- të jetë nga radhët e mësimdhënësve të lëndës/profesionit/sektorit përkatës në shkolla fillore/të mesme në RMV;
- të ketë të paktën 7 vjet përvojë pune në një institucion arsimor të verifikuar dhe/ose mësimdhënës nga institucione të arsimit të lartë të akredituar nga fusha përkatëse, përparësi ka kandidati me përvojë si mentor praktikanti;

III. Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim:

- fletëparaqitje (formulari i vendosur në ueb-faqen: www.dic.edu.mk);
- certifikatën e shtetësisë;
- një kopje të noterizuar të certifikatës/diplomës së arsimit të lartë përkatës;
- vërtetimin në origjinal të themelimit të marrëdhënies së rregullt të punës dhe përvojë pune adekuate prej të paktën 7 vjetësh si mësimdhënës/bashkëpunëtor profesional në veprimtarinë edukative-arsimore, të lëshuar nga shkollat fillore/të mesme në RMV;

- provë për realizim të mentorimit (*vendim për caktimin si mentor dhe programi për mbështetjen e praktikantit*) në qoftë se ka.

IV. Qendra Shtetërore e Provimeve do të bëjë përzgjedhje sipas kritereve të mësipërme, dhe në qoftë se në konkurs aplikojnë një numër më i madh kandidatësh sesa kërkohet për një lëndë dhe/ose profesion/sector të caktuar që i plotësojnë kushtet e konkursit, në intervistë do të thirren kandidatët që kanë përvojë të mëparshme si mentorë praktikantësh, e më pas do të vijojë përzgjedhja përfundimtare.

V. Përzgjedhja e bashkëpunëtorëve të jashtëm - kryetarë dhe zëvendës-kryetarë të komisioneve profesionale për realizimin e provimit të praktikantit për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesionalë nga shkollat fillore dhe të mesme, bëhet në mënyrën dhe procedurën e përcaktuar me Rregulloren për mënyrën, procedurën dhe kriteret e përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve të jashtëm të Qendrës Shtetërore të Provimeve.

VI. Kandidatët që do të përzgjidhen për kryetarë dhe zëvendës-kryetarë të komisioneve profesionale për realizimin e provimit të praktikantit për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesionalë, do të angazhohen për një periudhë prej **4 (katër) sesione provimi** (sesionin e pranverës dhe të vjeshtës për vitin 2025 dhe 2026).

VII. Afati për aplikimin e kandidatëve të interesuar është 5 (pesë) ditë.

VIII. Përzgjedhja e bashkëpunëtorëve të jashtëm do të kryhet në afat prej 18 (tetëmbëdhjetë) ditësh pas përfundimit të afatit të aplikimit.

IX. Dokumentacioni i dërguar pas afatit, jovalid dhe jo i plotë nuk do të jetë lëndë shqyrtimi.

X. Fletëparaqitja e çlotësuar me dokumentacionin e duhur dorëzohet në Arkivin e Qendrës Shtetërore të Provimeve (nga ora 10:00 deri në orën 14:00) ose me të dërgesë të rekomanduar postare, në këtë adresë: *Qendra Shtetërore e Provimeve - Shkup, rr. "Vasil Gjorgov" p.n. 1000 Shkup*, me shënimin "**Për konkursin publik për kryetarë dhe zëvendës-kryetarë të komisioneve profesionale për realizimin e provimit të praktikantit**".

XI. Informacione shtesë për konkursin publik mund të merren në numrin e telefonit 075/300-606, çdo ditë pune nga ora 10.00 deri më 14.00.

QENDRA SHTETËRORE E PROVIMEVE SHKUP